


KOMBET E BASHKUARA TRIBUNALI PENAL NDËRKOMBËTAR PËR ISH-JUGOSLLAVINË



:: ARRITJET E TRIBUNALIT

Drejtësi për viktimat

Tribunali ka ngritur aktakuzat kundër 161 të akuzuarve për krime të kryera kundër dhjetëra mijëra viktimave në territorin e ish-Jugosllavisë.

Udhëheqësit vihen para përgjegjësisë

TPNJ-ja ka ngritur aktakuzë ndaj një kryetari shteti, ndaj shefave të shtabeve ushtarake dhe shumë udhëheqësve të tjerë të nivelit të lartë dhe të mesëm. Falë TPNJ-së nuk shtrohet më pyetja a duhet të vihen liderët para përgjegjësisë, por kur mund të vihen ata para përgjegjësisë.

Individualizimi i fajit

Udhëheqësit e shpallur fajtorë dhe të tjerët nuk mund të fshihen më pas ndonjë grupi. Kjo mbron bashkësitë etnike nga fajësimi dhe kontribuon në parandalimin e urrejtjes dhe promovimin e pajtimit në ish-Jugosllavi.

Zëri i viktimave

Tribunali mundësoi që të dëgjohet zëri i mijëra viktimave. Shumë prej tyre treguan guxim të veçantë dhe në këtë mënyrë kontribuan në procesin e zbulimit të së vërtetës.

Vërtetimi i fakteve

TPNJ ka vërtetuar shumë fakte përtej çdo dyshimi të arsyeshëm në lidhje me krimet e kryera në territorin e ish-Jugosllavisë. Nëpërmjet proceseve gjyqësore, Tribunali kontriboi në krijimin e arkivave historike, duke iu kundërvënë mohimit dhe ndryshimit të historisë.

Forcimi i pushtetit ligjor

Tribunali ka nxitur gjyqësorët në ish-Jugosllavi që të vazhdojnë punën e tyre. Tribunali punon në partneritet me gjykatat vendore në rajon si pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme për jetësimin e drejtësisë.

Zhvillimi i të drejtës ndërkombëtare

Tribunali vërtetoi efektshmërinë dhe transparencën e drejtësisë ndërkombëtare. Arritjet e Tribunalit frymëzuan krijimin e gjykatave të tjera ndërkombëtare, përfshirë Tribunalin Penal Ndërkombëtar për Ruandën dhe Gjykatën Ndërkombëtare Penale.

Kriminelët e luftës para drejtësisë, drejtësi për viktimat



United Nations
Kombet e Bashkuara



International Criminal Tribunal
for the former Yugoslavia
Tribunali Penal Ndërkombëtar
për ish-Jugosllavinë

Drejtesia është element i pazëvendësueshëm në procesin e pajtimit kombëtar. Ajo është thelbësore për rivendosjen e marrëdhënieve paqësore dhe normale ndërmjet njerëzve të cilët jetuan në një kohë të sunduar nga terrori. Ajo thyen ciklin e dhunës, të urrejtjes dhe hakmarrjes jashtëgjyqësore. Rrjedhimisht paqja dhe drejtësia janë të pandara.

Antonio Cassese, ish-Kryetar i TPNJ-së

Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ) e ka ndryshuar në mënyrë të pakthyeshme të drejtën ndërkombëtare me nxjerrjen para përgjegjësisë të udhëheqësve të lartë për krimet e tmerrshme që ndodhën në ish-Jugosllavi gjatë viteve 1990. Njëpërmjet vendimeve udhërrëfyese në lidhje me gjenocidin, krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit, Tribunali ka vërtetuar se pozita e një individi nuk mund të jetë më mburojë ndaj ndjekjes së tij penale. Duke individualizuar fajin, duke ndjekur penalisht kriminelët e luftës dhe duke bërë që të dëgjohet zëri i viktimave, Tribunali ka konfirmuar bindjen se “paqja dhe drejtësia janë të pandara”.

:: THEMELIMI

Konfliktet që ndodhën në ish-Jugosllavi rezultuan në krimet më të shëmtuara të kryera në Evropë që prej përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Raportet për shfarosje masive, vrasje, tortura, përdhunime dhe plaçkitje të cilat ndodhën në rajon, e detyruan bashkësinë ndërkombëtare të ndërhynte vendosmërisht.

KONFLIKTET

- Kroaci (1991-1995)
- Bosnjë dhe Hercegovinë (1992-1995)
- Kosovë (1998-1999)
- Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (2001)



Më 25 maj të vitit 1993 duke u bazuar në Kapitullin VII të Kartës së OKB-së, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara miratoi Rezolutën 827 e cila themeloi TPNJ-në. Kjo datë shënoi fillimin e dhënies fund të mosndëshkueshmërisë për krimet e luftës në ish-Jugosllavi. Mandati i Tribunalit është procedimi penal dhe gjykimi i individëve përgjegjës për shkelje të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë që nga viti 1991. Në këtë mënyrë Tribunali luan një rol të rëndësishëm për paqen dhe pajtimin në ish-Jugosllavi.

:: ORGANIZIMI

Tribunali përbëhet nga tri organe të pavarura: **Dhoma Gjyqësore, Zyra e Prokurorit (ZP), dhe Sekretaria.** Për shkak të rolit të saj thelbësor gjatë procedurave gjyqësore, pala **mbrojtëse** mund të konsiderohet si përbërësi i katërt.

:: DHOMAT GJYQËSORE

Dhomat dëgjojnë dëshmitë e paraqitura nga Prokuroria dhe Mbrojtja dhe shpallin vendime për përgjegjësinë penale të të akuzuarve. Dhomat përbëhen prej 16 gjykatësve të përhershëm, të udhëhequr nga Kryetari i Tribunalit, dhe prej më së shumti 12 gjykatësve të cilët quhen gjykatës *ad litem* që emërohen për çështje të veçanta gjyqësore. Gjykatësit ndahen në tri Dhoma Gjyqësore dhe në Dhomën e Apeleve. Në gjykimin e një çështjeje marrin pjesë tre gjykatës, ndër të cilët njëri është kryegjykatës dhe përgjegjës për mbikëqyrjen e procedurave gjyqësore. Pesë gjykatës shqyrtojnë apeliemet.

:: ZYRA E PROKURORISË

Zyra e Prokurorisë është përgjegjëse për hetime dhe ndjekje penale. E udhëhequr nga Prokurori, Zyra e Prokurorisë përbëhet nga avokatë gjyqësorë, hetues, specialistë ushtarakë, ekspertë të ligjit dhe politikës së ish-Jugosllavisë dhe nga një numër i madh i personelit ndihmës.

Unë vërtet dëshiroja të shkoja në Hagë. Doja të shihja [tre të pandehurit] dhe t'i pyesja pse vepruan në këtë mënyrë. Pse i vranë gjithë ata njerëz? Pse na e shkatërruan fshatin? Doja vetëm që njëri prej tyre... të më tregonte pse vepruan kështu.

Deklaratë e një vejushë boshnjake e cila dëshmoi në gjykimin e individëve që ajo i konsideronte përgjegjës për vdekjen e burrit të saj

Prokurori është i pavarur dhe nuk kërkon e as nuk merr udhëzime nga agjenci të jashtme siç janë qeveritë, organizatat ndërkombëtare e as nga të dy organet tjera të Tribunalit. Në përputhje me rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe me Statutin e Tribunalit, shtetet anëtare të OKB-së janë të obliguara të bashkëpunojnë në hetimet dhe procedimet penale të Zyres së Prokurorisë.

:: SEKRETARIA

Sekretaria është përgjegjëse për të gjitha aspektet e administrimit të Tribunalit. Ky administrim, midis tjerash, përfshin administrimin e

Punonjësit e Prokurorisë, të Dhomave Gjyqësore dhe Sekretarisë janë nga më shumë se 80 vende të ndryshme, duke e bërë TPNJ-në, një Tribunal të vërtetë ndërkombëtar.

gjykatës, ndihmën juridike dhe çështjet e mbrojtjes, përkthimet me shkrim dhe me gojë, ndihmën për viktimat dhe dëshmitarët, sigurinë dhe informacionin publik.

Sekretaria administron edhe Njësinë e Paraburgimit të Tribunalit (NjP), ku mbahen personat e akuzuar pas transferimit të tyre në Hagë për t'u gjykuar. Meqenëse, si në çdo sistem juridik, të akuzuarit në Tribunal gëzojnë të drejtën të konsiderohen të pafajshëm derisa të provohet fajti i tyre nga një gjykatë e ligjshme, NjP-ja e Tribunalit është qendër paraburgimi për të akuzuarit, dhe jo burg. Duke funksionuar në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut lidhur me trajtimin e të paraburgosurve, NjP-ja e Tribunalit ka mbajtur më shumë se 140 persona gjatë periudhave të ndryshme që nga prilli i vitit 1995. Të paraburgosurit në NjP nuk ndahen në bazë të përkatësisë së tyre etnike, kombëtare, fetare ose klasore.

:: AVOKATËT MBROJTËS



© ICTY/Z. Lestic

Avokatët mbrojtës përfaqësojnë të akuzuarin gjatë procedurave gjyqësore në Tribunal. TPNJ-ja paguan shpenzimet e avokatëve mbrojtës të të akuzuarit nëse ata nuk kanë mjete financiare të mjaftueshme për shlyerjen e pagesës. Avokatët mbrojtës janë anëtarë të Shoqatës së Avokatëve Mbrojtës, organizatë e cila është e pavarur nga Tribunali.

:: PROCEDURAT PENALE

Procedurat penale përcaktohen nga Rregullorja e Procedurës dhe e Provave të Tribunalit. Të shkruara dhe të ndryshuara nga gjykatësit e Tribunalit, këto rregulla rregullojnë mënyrën e zhvillimit të procesit gjyqësor dhe sigurojnë gjykim të drejtë për të akuzuarin. Procedurat e Tribunalit huazojnë si nga tradita e të drejtës anglosaksone po ashtu dhe nga ajo e të drejtës civile, duke reflektuar karakterin ndërkombëtar të Tribunalit.



© ICTY/OTP

Procesi ligjor në Tribunal vihet në lëvizje nga Prokurori. Në Tribunal nuk ka gjykatës hetues. Është Prokurori ai që vendos për nisjen e një hetimi, cilët persona të ndiqen penalisht dhe cilat duhet të jenë akuzat. Nëse bindet se ekzistojnë prova të arsyeshme se një person ka kryer një krim, Prokurori formulon një aktakuzë duke u bazuar në provat e mblidhura nga hetimet në vendin e ngjarjes, nga dokumentet nga deklaratat e viktimave dhe nga dëshmitarët e tjerë.

Hapi tjetër merret nga Dhoma Gjyqësore. Para se të mund të akuzohet dhe të arrestohet një person, një gjykatës duhet të bindet se ekzistojnë

prova të mjaftueshme për nxjerrjen e të akuzuarit para gjyqit. Pasi bindet për këtë, ai ose ajo konfirmojnë aktakuzën dhe lëshojnë një fletarrestim.

Pas arrestimit ose dorëzimit vullnetar të të akuzuarit, ai transferohet në Njësinë e Paraburgimit të Tribunalit. Në paraqitjen e parë të të akuzuarit në gjyq, ai mund të vetëdeklarohet fajtor ose i pafajshëm lidhur me akuzat në aktakuzë. Nëse i akuzuari vendos që të mos deklarohet, Dhoma Gjyqësore paraqet deklarinë e pafajësisë në emër të tij. Nëse i akuzuari vetëdeklarohet fajtor, procesi gjyqësor nuk do të zhvillohet por caktohet data e seancës për shqiptimin e dënimit. Nëse i akuzuari vetëdeklarohet i pafajshëm, atëherë planifikohet zhvillimi i procesit gjyqësor.

I akuzuari mund të përfaqësohet nga një avokat ose mund të zgjedhë që të përfaqësohet vet. Nëse dëshiron të ketë avokat, ai mund të zgjedhë avokatin e tij ose avokati mund t'i caktohet nga Sekretaria. Çdo çështje gjyqësore gjykohet nga tre gjykatës, njëri prej të cilëve duhet të jetë gjykatës i përhershëm. Gjykatësit dëgjojnë dëshmitë që paraqesin Prokuroria dhe Mbrojtja gjatë gjykimit. Dhoma Gjyqësore mund të urdhërojë paraqitjen e provave shtesë si ndihmesë për përcaktimin e përgjegjësisë së të akuzuarit.

Pas paraqitjes së provave nga Prokuroria dhe Mbrojtja, Dhoma Gjyqësore përfundon procesin gjyqësor dhe diskuton në seancë të mbyllur për vendimin. Në momentin kur marrin vendimin përfundimtar mbi pafajësinë ose fajësinë dhe dënimin e të akuzuarit, gjykatësit e Dhomës Gjyqësore shqiptojnë aktgjykimin publikisht.

Të dy palët mund të apelojnë aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore. Në rastet të tilla Dhoma e Apelit jep vendimin përfundimtar.

:: DËNIMET DHE VUAJTJA E DËNIMEVE

Një personi të shpallur fajtor mund t'i jepet dënim për një afat kohor deri me burgim të përjetshëm. TPNJ-ja nuk ka dënim me vdekje. Dënimet vuhën në njërin prej shteteve që kanë marrëveshje me TPNJ-në për pranimin e personave të dënuar nga TPNJ-ja.

.....

Unë nuk mund t'i ngjall të vdekurit [dhe] nuk mund ta lehtësoj dhimbjen e familjeve me dëshminë time, mirëpo dua të kontribuoj në zbulimin e të vërtetës së plotë.

Deklaratë e Momir Nikoliqit, Oficer i Shërbimit të Zbulimit Serb të Bosnjës, i dënuar me 20 vjet burgim pasi u vetëdeklaroi fajtor për rolin që luajti në krimet në Srebrenicë

.....

:: ARDHMËRIA E TRIBUNALIT

Në vitin 2003, Këshilli i Sigurimit miratoi Strategjinë Përmblylëse të Tribunalit e cila ofroi udhërrëfyes për mbylljen e organizuar dhe në faza të Tribunalit. Kryetari i Tribunalit dhe Prokurori kohët e fundit informuan Këshillin e Sigurimit se të gjitha gjykimet e shkallës së parë pritet të përfundojnë brenda vitit 2013 dhe të gjitha apelet të përfundojnë brenda vitit 2014, ndonëse përlogaritja e këtyre afateve ndoshta do të duhet të rivlerësohet.



© ICTY/Outreach

Tribunali është gjykatë *ad hoc*, themeluar në kohën kur institucionet vendore në ish-Jugosllavi nuk ishin të gatshme ose të afta për kryerjen e proceseve gjyqësore të drejta dhe të paanshme. Në kuadër të strategjisë përmblylëse, Këshilli i Sigurimit i dha Tribunalit leje dhe udhëzime të qarta për të ndihmuar në ndërtimin e kapaciteteve të gjykatave shtetërore në ish-Jugosllavi për procedimin e çështjeve gjyqësore në lidhje me krimet e luftës. Që nga ajo kohë, Tribunali është angazhuar në një program të gjerë të mbështetjes dhe ndihmës ndaj autoriteteve shtetërore për forcimin e aftësisë së tyre lidhur me procedimin e drejtë dhe pa ndërhyrje politike të çështjeve gjyqësore.

Prokuroria ka transferuar vëllime me prova të rëndësishme duke iu mundësuar prokurorëve në nivel shtetëror që të formulojnë aktakuzat të rëndësishme dhe t'ia paraqesin ato gjykatave. Gjithashtu gjykatave në ish-Jugosllavi u janë përcjellë gjithsej tetë çështje gjyqësore në lidhje me 13 të akuzuar prej TPNJ-së. Tribunali ka qenë mbështetës aktiv i themelimit të Dhomave dhe Gjykatave Speciale për Krime të Luftës në ish-Jugosllavi, duke i këshilluar ato për reformat kyçe të kodeve penale dhe mundësuar trajnimin e zyrtarëve të gjyqësorit dhe personelit tjetër. Ka përfunduar pjesa më e madhe e çështjeve që Tribunali ua ka përcjellë gjykatave të shteteve të ish-Jugosllavisë. Gjyqësorët e rajonit kanë proceduar dhe do të procedojnë penalisht qindra të dyshuar të tjerë. Në verë të vitit 2010, në bashkëpunim me zyrën e ODHIR-it të OSBE-së dhe të UNICRI-t, Tribunali filloi Projektin "Drejtësi për Krimet e Luftës" me qëllim mundësimin e transferimit të ekspertizës dhe materialeve të TPNJ-së juristëve profesionistë në ish-Jugosllavi dhe zgjerimin e mëtejshëm të kapacitetit të gjyqësorëve të rajonit për procedimin e çështjeve komplekse gjyqësore të krimeve të luftës.

Më 22 dhjetor 2010, Këshilli i Sigurimit miratoi Rezolutën për ngritjen e organit të ri që do të merret me përfundimin e detyrave të mbetura të TPNJ-së dhe TPNR-së pas përfundimit të mandatit të tyre, i cili do të trashëgojë juridiksionin, të drejtat, detyrimet dhe detyrat themelore të TPNJ-së dhe TPNR-së. Mekanizmi do të fillojë punën më 1 korrik 2013 për TPNJ-në dhe, midis tjerash, do të ketë kompetencë të procedojë penalisht të akuzuar ende të pahapur që do të arrestohen pas përfundimit të mandatit të Tribunalit.



United Nations
Kombet e Bashkuara



International Criminal Tribunal
for the former Yugoslavia
Tribunali Penal Ndërkombëtar
për ish-Jugosllavinë

:: TË DHËNAT PËR KONTAKT ::

Communications Service
Churchillplein 1, 2517 JW Hagë, Holandë
P.O. Box 13888, 2501 EW Hagë, Holandë

Tel: +31 (70) 512 5343 / 5356 / 8752
Fax: +31 (70) 512-5355

Faqja e internetit:
www.icty.org/sq

Ndiq TPNJ-në në



- 2011 -

© TPNJ/Shërbimi për Komunikim/Njësia Grafike
- Nuk është dokument zyrtar -

Programi për Komunikim dhe Ndërgjegjësimin ndihmohet zemërgjërisht prej Bashkimit Evropian.

